

Melos Kolshi, MA<sup>1</sup>

UDC: 347.965.42(091)  
347.965.42(73)

**E DREJTA KUSHTETUESE E PRESIDENTIT PËR FALJE - RASTI I  
KOSOVËS**

**УСТАВНО ПРАВО НА ПРЕТСЕДАТЕЛОТ ДА ПОМИЛУВА -  
СЛУЧАЈ  
КОСОВО**

**THE PRESIDENT'S CONSTITUTIONAL RIGHT TO GRANT  
PARDONS - CASE OF KOSOVO**

**Abstract**

The Constitution of the Republic of Kosovo gives the President the power to pardon certain individuals. Moreover, most of the Constitutions of different states consider pardon power as an authority that should be granted to the President of the state.

Pardon is an act which is drafted by the Head of State and issued in the form of a decision (decree). By this act, certain people are fully or partially released from the execution of the sentence, therefore being pardoned by the President. Within the pardon process, four entities participate: the convict (relatives of the convict or the authorized representative), the Ministry of Justice and the Presidency (including the President and the Commission formed by the President).

The paper 'The President's constitutional right to pardon - The case of Kosovo', addresses and analyzes the role of the President in the

---

<sup>1</sup> Melos Kolshi është Master i Shkencave Kushtetuese-Administrative. Studimet themelore dhe ato post-diplomike i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" - Fakulteti Juridik. Email: kolshimelos@gmail.com

Republic of Kosovo, in granting pardons to convicts. This paper tackles in detail the convict's path to seek pardon. Furthermore, the paper also analyzes the criteria and procedures that the convict must follow to seek pardon hence ending his/her parole.

The paper further analyzes the concept of the Convicted Person. A convicted person means an individual convicted by a final decision of a court in the Republic of Kosovo. A Convict in the Republic of Kosovo, in order to seek pardon, has to go through several procedures. The 'journey' of the convict towards pardon is regulated by the Law on Pardon and the Regulation on Criteria and Procedures for Pardon of convicted persons.

**Keywords:** *President, Pardon Power, Request, Convicted Person, Ministry, Commission.*

## **HYRJE**

*Tema "E drejta kushtetuese e Presidentit për Falje - Rasti i Kosovës", paraqet një studim të fushës kushtetuese, që trajton një temë të ngushtë dhe ka për qëllim sqarimin e rolit të presidentit në të drejtën e tij lidhur me faljen si atribut kushtetues që i takon. Presidenti, si shef i shtetit, ka kompetenca të shumta që përcaktojnë rolin e tij në një sistem kushtetues. Njëra ndër atributet e tij është falja presidenciale. E drejta kushtetuese e faljes e cila sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës i takon vetëm presidentit, është një çështje shumë pak e trajtuar në teorinë dhe praktikën kushtetuese, andaj duke pasur parasysh këtë fakt, ky punim synon që të ofroj për lexuesin një studim analitik, krahasues, statistikor dhe juridik, i cili sqaron çështjet kyçe që i përkasin kësaj tematike të ngushtë, siç janë: definicioni i faljes, procedurat që duhet ndjekur i dënuari në mënyrë që ta gëzoj institutin e faljes presidenciale në Republikën e Kosovës, analizë lidhur me ligjin për faljen në Republikën e Kosovës, figura e presidentit, ligji për presidentin, aktet e tjera juridike që kanë të bëjnë me faljen, paanshmëria dhe anshmëria e presidentëve në zbatimin e faljes në Republikën e Kosovës dhe shqyrtime krahasuese me disa kushtetuta të vendeve tjera.*

*Falja nënkupton pushtetin e jashtëzakonshëm ekzekutiv të Presidentit për t'i falur personat e dënuar për vepër penale, duke i liruar nga dënimi i përcaktuar nga gjykata. Falja është një institut i së drejtës përmes të cilit mëtohet të shpërblehen të dënuarit për vepra penale, të*

*cilët kanë kryer borxhin e tyre ndaj shoqërisë për shkeljet e bëra. Tutje, Falja paraqet një akt i cili hartohet nga Shefi i Shtetit dhe nxirret në formë të vendimit (dekretit), me të cilin akt, personat e caktuar emër për emër lirohen plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit, i shqiptuar nga Gjykatat kompetente.*

## **1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI FALJEN PRESIDENCIALE**

### **1.1. Përkufizimi i faljes presidenciale**

*Falja është akt të cilin e nxjerr shefi i shtetit ose qeveria e shtetit. Falja nxirret në formë të vendimit me të cilin personat e caktuar emër për emër lirohen nga ndjekjet penale, lirohen plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësohet dënimi i shqiptuar me dënim më të butë apo me dënim me kusht, apo caktohet shlyerja e dënimit nga evidenca e të dënuarve.<sup>2</sup>*

*Faljaparaqet një pushtet të jashtëzakonshëm të Presidentit për t'i falur personat e dënuar për krime, duke i liruar plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit përfundimtar i gjykatës.*

*Kjo drejtë i jepet Presidentit në shumicën e Kushtetutave të shteteve, si në Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shqipërisë, Maqedonisë etj. Në kuptim të kësaj vjen në shprehje shembulli i Gjykatës Kushtetuese së Sllovakisë, ku përmes vendimit të saj Nr. PL. US 8/97, 24.06.1998, ka vendosur që e drejta për të vendosur falje të personave të dënuar është ekskluzive kompetencë e Presidentit të Republikës dhe kjo e drejtë nuk mund të delegohet në asnjë autoritet tjetër shtetëror.<sup>3</sup>*

Falja është një institut i së drejtës përmes të cilit mëtohet të shpërblehen të dënuarit për vepra penale, të cilët kanë kryer borxhin e tyre ndaj shoqërisë për shkeljet e bëra. Tutje, instituti i faljes shihet si një mjet për të treguar mëshirë për të dënuarit, posaçërisht është treguar një mekanizëm tejet i rëndësishëm në kohën dhe vendet që është aplikuar dënimi me vdekje. Qëllimi i dënimeve me burg në ditët e sotme më shumë ndërlihet me përmirësimin e sjelljeve të të dënuarve ashtu që të arrihet risocializmi dhe riintegrimi i plotë i këtyre personave. Rrjedhimisht, rikthimi i të dënuarve do të duhej të paraqiste më shumë dobi

<sup>2</sup> Salihu Ismet Dr; “E drejta penale – Pjesa e përgjithshme”; Prishtinë, Tetor 2015; faqe 569.

<sup>3</sup> Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë; Rasti Nr. PL. US 8/97, 24.06.1998

sesa probleme për shoqërinë në përgjithësi. Andaj, falja si e tillë duhet të synojë të ndërtojë mbi këto parime, duke i shërbyer së mirës së përgjithshme.<sup>4</sup>

Qëndrueshmëria e fuqisë për të falur shkelësit është një fenomen i jashtëzakonshëm, në këndvështrimin disa arsyeve në dukje të fuqishme për zhdukjen e këtij institucioni. Këto arsye kanë karakter ideologjik dhe praktik. Bazat ideologjike rrjedhin nga fakti se fuqia e faljes duket të jetë më shumë një mbijetesë arkaike e një epoke të hershme, gjatë së cilës shteti drejtohej nga një sundimtar i gjithëfuqishëm, i cili mund të ketë një dëshirë të rastit për të demonstruar prirjen e tij dashamirëse, në rastin tonë faljen. Kjo duket një anomali në demokraci kushtetuese, që ka një angazhim - të paktën në parim - për një ndarje delikate të pushteteve të dizajnuara për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit. Kjo pavarësi do të duket se kërcënohet nga dhënia në autoriteti jo-gjyqësor që është fuqia për të falur autorë të dënuar dhe të dënuar në mënyrë të rregullt me rrjedhën e procesit gjyqësor.<sup>5</sup>

Falja, të qenit atribut që zotërohet nga Presidenti gjithëherë ka ngjallur polemika të ndryshme dhe dyshese për mundësinë e keqmenaxhimit të Presidentit lidhur me këtë kompetencë. Në një studim të vitit 1977, të Northwestern University School of Law, lidhur me ‘fuqinë false’, tregon se në shumicën dërmuese të vendeve, kompetencat e faljes i janë dhënë kryetarit të shteteve dhe se në secilin shtet ekzistonte ky atribut, qoftë presidenti apo monarku.<sup>6</sup>

Një dallim i cili ishte ndryshe nga praktika e shteteve tjera në atë kohë, mund të bëhet duke iu referuar në historitë kushtetuese të Francës dhe Shtetet e Bashkuara.

Në Francën postrevolucionare, pranimin e nevojës për falje pushteti nuk i shpërndau plotësisht fuqinë vendimmarrëse vetëm në duart e kreut të shtet në cilësinë e tij si shefi ekzekutiv. Por, Kushtetuta parashikonte krijimin e një Këshilli këshillëdhënës, në të cilin të tre degët të qeverisë ishin të përfaqësuar. Në mënyrë të ngjashme, Kushtetuta e vitit 1848 parashikonte si të detyrueshme konsultimin me Conseil d'Etat, dhe

<sup>4</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi; “Falja në Kosovë - Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirisht me kusht”; Prishtinë, Janar 2012; faqe 6.

<sup>5</sup> Sebba Leslie; “The Pardon Power - A World Survey”, Vol. 68, No. 1; Northwestern University School of Law; Printed in U.S.A. 1977, page 83-84.

<sup>6</sup> Shih tabelën: [https://scholarlycommons.law.northwestern.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6010&context=jclc&fbclid=IwAR3-Rftxq1S1JEW7xJdxIWQfcgp8yk\\_6Upy-B2eZuG45AkuK5A-6pGP\\_QMw](https://scholarlycommons.law.northwestern.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6010&context=jclc&fbclid=IwAR3-Rftxq1S1JEW7xJdxIWQfcgp8yk_6Upy-B2eZuG45AkuK5A-6pGP_QMw); faqe 85-110

në raste serioze (d.m.th., dënime në Gjykatën e Lartë) e drejta për falje i rezervohej vetëm Asamblesë Kombëtare.<sup>7</sup>

Në Shtetet e Bashkuara mbizotëronte teoria se fuqia për të dhënë falje, si të gjitha fuqitë e tjera, në fund të fundit qëndronte te njerëzit, të cilët për pasojë ishin në gjendje ta delegonin atë në cilindo organ që ata të zgjidhnin. Trupi elektoral preferonte të ndryshonte atributin e faljes nga epoka në epokë. Gjatë periudhës para Pavarësisë në SHBA, ishin tre modele për institucionin e faljes: (a) dhënia e pushtetit guvernatorit; (b) dhënia e pushtetit guvernatori që vepron me pëlqimin e Këshillit Ekzekutiv; (c) dhënia e pushtetit në legjislaturë.<sup>8</sup>

Shpeshherë hasim në ngatërresën që e bëjnë gazetarët ose edhe vet juristët, lidhur me faljen dhe amnistinë. Ndoshta në dëgjim të parë këto dy teori duken sinonime mirëpo në aspektin kushtetues ekziston dallim mes tyre. Kur i shikon të dy këto institute, amnistia është falje dhe harresë e një vepre penale, ndërsa falja quhet keqardhje apo mëshirë. Amnistia mund t'u jepet personave që nuk janë përballur me gjyq dhe janë dënuar. Përkundrazi, u jepet falje personave që janë dënuar. Kur falja u jepet vetëm individëve, amnistia i jepet një grupi individësh. Falja jepet vetëm pasi të shqiptohet një aktgjykim ndërsa amnistia jepet edhe para gjykimit përfundimtar. Në falje, të dhënat penale të një individi nuk fshihen pasi gjykata tashmë e ka dënuar atë person, ndërsa në amnisti të dhënat fshihen edhe pa u shqiptuar aktgjykimi.<sup>9</sup>

## 1.2. Baza juridike përkitazi me faljen presidenciale në Republikën e Kosovës

Instituti i faljes në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin e veçantë për faljen e gjithashtu me akte tjera nënligjore. Mirëpo ky institut në legjislacionin vendor ka qenë prezent edhe para hartimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës edhe pse me përbërje më pak të detajizuar se tash.

<sup>7</sup> Sebba Leslie; “*The Pardoning Power - A World Survey*”, Vol. 68, No. 1; Northwestern University School of Law; Printed in U.S.A. 1977, page 111

<sup>8</sup> Ibid: page 112

<sup>9</sup> Difference Between Amnesty and Pardon;

[http://www.differencebetween.net/miscellaneous/culturemiscellaneous/difference-between-amnesty-andpardon/?fbclid=IwAR11lrLTC\\_vG7uIfA6vG2DJfVIgeTHPt\\_upS4Goc6jlkWT7zGkn785Vao0](http://www.differencebetween.net/miscellaneous/culturemiscellaneous/difference-between-amnesty-andpardon/?fbclid=IwAR11lrLTC_vG7uIfA6vG2DJfVIgeTHPt_upS4Goc6jlkWT7zGkn785Vao0); Qasur për herë të fundit më: 12.05.2022.

Në kompetencat e Kryetarit të shtetit në Kornizën Kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme, përmenden disa nga kompetencat që i gëzon edhe Presidenti i Republikës së Kosovës<sup>10</sup>, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por jo edhe instituti faljes, që nënkupton se falja nga Kryetari i Kosovës (lexo: Presidenti) në atë kohë nuk kishte ekzistuar.<sup>11</sup> Shumica e kompetencave që Kryetarit të Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese ushtroheshin në konsultim dhe në koordinim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe në këtë kontekst ishin kompetenca të kufizuara për shkak të pozitës kushtetuese dhe ndërkombëtare që kishte Kosova në këtë periudhë, respektivisht në periudhën 2001-2007.<sup>12</sup>

Gjithashtu edhe me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, që ishte i hartuar nga UNMIKU, flitej për faljen dhe amnistinë, ku thuhej si në vijim: “Me falje, personave të caktuar emrat e të cilëve saktësisht caktohen, u jepet lirimi nga ndjekja penale, lirimi i plotë ose i pjesërishtëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit të shqiptuar me një dënim më të butë ose dënimi me kusht a me shlyerje të dënimit”.<sup>13</sup>

Deri në vitin 2008, me përfundimin e administrimit ndërkombëtar në Kosovë, përkundër përfshirjes së dispozitave që ndërlidhen me falje në Kodin Penal të Kosovës, dokumentet tjera ligjore nuk ishin zhvilluar, gjë që kishte pamundësuar aplikimin e institutit të faljes. Në vitin 2008, me hyrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në fuqi, instituti i faljes ishte përfshirë si kompetencë e Presidentit, gjë e cila rezultoi me

<sup>10</sup> Neni 9.2.3.; *Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë*; Dy nga kompetencat ceremoniale të cilat i garantoheshin Kryetarit të Shtetit, në atë kohë e të cilat janë të ngjashme me kompetencat e tashme të Presidentit të Republikës së Kosovës, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ishin: Të paktën njëherë në vit ia paraqet një raport Kuvendit të Kosovës mbi gjendjen e përgjithshme në Kosovë dhe (d) Jep medalje dhe shpreh mirënjohje. Gjithashtu kishte edhe kompetenca të tjera të ngjashme, por ishin më të kufizuara se sa kompetencat që gëzon sot Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilat i garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës; Prishtinë, 2001.

<sup>11</sup> Neni 9, Pjesa 2; *Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë*; Prishtinë, 2001.

<sup>12</sup> Muqaj Florent, Jashari Murat; “*Presidenti si përfaqësues i unitetit të popullit*”; Prishtinë, 2019; faqe 105.

<sup>13</sup> Neni 112; *Kodi i Përkohshëm Penal, UNMIK/RREG/2003/25*; Gazeta Zyrtare; 6 Korrik 2003.

aprovimin e Ligjit për Faljen si dhe faljen e 62 të dënuarve me rastin e një vjetorit të pavarësisë së vendit, përkatësisht 17 shkurt 2009.<sup>14</sup>

Instituti i faljes garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, saktësisht tek Kompetencat e Presidentit të Republikës së Kosovës, ku thuhet se Presidenti “shpall falje individuale, në pajtim me ligjin”.<sup>15</sup> E drejta e faljes është siguruar përmes Kodit Penal, i cili kishte hyrë në fuqi më 2004, mirëpo kjo kompetencë asnjëherë nuk ka gjetur zbatim deri më 2009 pasi kishte munguar ligji përcjellës për të rregulluar funksionimin e institutit të faljes. Më 15 janar 2009, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Presidentin ka miratuar Ligjin për Faljen, ligj ky që sqaron në detaje të gjitha temat që kanë të bëjnë me institutin e faljes, si atribut që e gëzon Presidenti i Republikës së Kosovës.<sup>16</sup> Ky ligj i përcakton autorizimet ligjore të Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje të faljes individuale.

Në Ligjin për Presidentin, nuk flitet ekskluzivisht për faljen si institut, vetëm se Ligji i referohet Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sa i përket kompetencave të Presidentit në tërësi por jo për ndonjë-rën prej tyre veçanërisht (lexo: kompetencën e faljes), ku saktësisht thuhet se “Presidenti i Republikës së Kosovës ushtron kompetencat që i janë akorduar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet në fuqi”.<sup>17</sup> Ndërsa, në Ligjin për Falje sqarohen të gjitha procedurat të cilat duhet ndjekur personi dënuar apo personi i autorizuar nga ai, në mënyrë që të arrihet deri tek falja nga Presidenti. Ligji i Faljes, faljen e sheh si pushtetin e jashtëzakonshëm ekzekutiv të Presidentit për t’i falur personat e dënuar për vepër penale, duke i liruar nga dënimi i përcaktuar nga gjykata.<sup>18</sup> Falja sipas Ligjit për Faljen të Republikës së Kosovës, është e drejtë e presidentit që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jo të rregullt e të rrallë për t’i shpërblyer sjelljet dhe karakteret e

<sup>14</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi; “*Falja në Kosovë – Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirimimit me kusht*”; Prishtinë, Janar 2012; faqe 6.

<sup>15</sup> Neni 84.29; *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, K-09042008*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë, 2008.

<sup>16</sup> *Ligji për faljen, Ligji Nr. 03/L-10*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë: Viti IV, Nr. 46; 15 Janar, 2009.

<sup>17</sup> Neni 6; *Ligji për Presidentin, Ligji Nr. 03/L-094*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë: Viti IV / Nr. 47; 25 Janar, 2009

<sup>18</sup> Neni 2; *Ligji për Faljen, Ligji Nr. 03/L-10*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë: Viti IV, Nr. 46; 15 Janar, 2009.

jashtëzakonshme ose t'i adresojë shqetësimet e jashtëzakonshme humanitare.<sup>19</sup>

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në kapitullin e XI të tij e saktësisht në Nenin 105, mes tjerash flet edhe për institutin e faljes. Ky nen flet për Amnistinë dhe Faljen, të dy këtotribute të cilat kanë për qëllim faljen apo zbutjen e dënimit për të dënuarit. Sipas kësaj dispozite, me falje personit të caktuar me emër u jepet lirimi i plotë ose i pjesërishtëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit me një dënim më të butë apo dënim me kusht ose shlyerja e dënimit.<sup>20</sup>

Disa nga Presidentët e Republikës së Kosovës, kanë nxjerrur rregullore e dekrete lidhur me këtë faljen, kështu duke i plotësuar hapësirat e nevojshme lidhur me këto procedura.<sup>21</sup> Kështu, në vitin 2009 Presidenti Fatmir Sejdiu kishte nxjerrë Dekretin e Kritereve për Falje i cili kishte shërbyer për tri vite të zbatimit të faljes. Ky Dekret kishte saktësuar tutje procedurat e zbatimit të faljes, dokumentet e nevojshme për vlerësimin e kërkesave të të dënuarve, si dhe formimin e një Komisioni Ad hoc për Falje.<sup>22</sup> Ky dekret më pas u shfuqizua me Dekretin Nr. DF- 001-2012, më datë 13 janar 2012, nga Presidentja e Republikës së Kosovës, në atë kohë, Atifete Jahjaga. Presidentja Atifete Jahjaga në vitin 2012 kishte nxjerrë një Dekret të ri të Kritereve për Falje, duke parë nevojën për saktësim të mëtutjeshëm të procedurave si dhe kritereve. Për dallim prej Dekretit të kaluar, Dekreti i Kritereve për Falje i nxjerrë në vitin 2012 ka plotësuar mangësitë procedurale ligjore për mbarëvajtjen e faljes.<sup>23</sup> Me këtë dekret të Presidentes Jahjaga, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e personave të cilët dëshirojnë të parashtrajnë kërkesë për falje e gjithashtu sqarohen procedurat që

<sup>19</sup> Neni 3.1; *Ibid.*

<sup>20</sup> Neni 105.2; *Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 06/L-074; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë, 14 Janar, 2019.*

<sup>21</sup> *Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, Nr. DF-001-2012; Dekret për përcaktimin e kritereve për dhënien e faljes personave të dënuar, Dekreti numër DF 001-2009, Presidenti i Republikës së Kosovës, 30 Janar, 2009; Rregullore (P) Nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 15 Nëntor, 2017.*

<sup>22</sup> *Instituti i Kosovës për Drejtësi; "Falja në Kosovë – Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirit me kusht"; Prishtinë, Janar 2012; faqe 10; Instituti i Kosovës për Drejtësi për këtë akt të Presidentit Fatmir Sejdiu citon dekretin "Dekret për përcaktimin e kritereve për dhënien e faljes personave të dënuar, Dekreti numër DF 001-2009, Presidenti i Republikës së Kosovës, 30 Janar, 2009."*

<sup>23</sup> *Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, Nr. DF-001-2012; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 13 Janar, 2012.*



personat e dënuar duhet ndjekur, për të kërkuar falje nga Presidenti i Republikës së Kosovës.<sup>24</sup> Gjithashtu në dekret flitet edhe për Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për falje, për të cilin Komision thuhet që formohet nga Presidentja e Republikës së Kosovës (në atë kohë Atifete Jahjaga).<sup>25</sup> Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për falje, sipas dekretit të Presidentes Jahjaga, përbëhet nga së paku 5 anëtarë, ku përfshihen anëtarë nga Zyra, shoqëria civile, përfaqësues të komunitetit akademik nga lëmia e drejtësisë, si dhe përfaqësues të gjyqësorit. Puna dhe përbërja e Komisionit mbetet konfidenciale dhe vendimet e këtij komisioni bëhen të ditura vetëm pas shpalljes së dekretit.<sup>26</sup> Pas kërkesës së të dënuarit dhe dërgimit të asaj kërkesë në Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për falje, si procedurë e radhës është shqyrtimi i kërkesës për falje, bazuar në dekretin e ish-Presidentes Jahjaga. Në bazë të kësaj dispozite të dekretit sqarohet puna dhe procedurat që duhet ndjekur Komisioni pasi që të pranojë kërkesat për falje, të cilët pas emërimit nga Presidentja Jahjaga mbledhen në një mbledhje të veçantë, ku më pas, pas shqyrtimit të atyre kërkesave, Komisioni shqyrton dhe vlerëson kërkesat për falje në pajtim me Ligjin për Falje dhe Dekretin. Pas shqyrtimit të kërkesave, Komisioni harton një raport me shkrim lidhur me shqyrtimin e kërkesës për Falje dhe i dorëzon Presidentës propozimin e arsyetuar.<sup>27</sup> Pas përfundimit të mandatit të Presidentës Atifete Jahjaga, vendin e saj e zuri, Presidenti Hashim Thaçi. Edhe Presidenti Thaçi, nxori një rregullore të veçantë për sa i përket procedurave dhe kriterëve të Faljes. Kjo Rregullore për nga përmbajtja është më e detajizuar se dekretet e kaluara presidenciale sa i përket kësaj fushe.<sup>28</sup> Për faktin që kjo rregullore është ende në fuqi, për përmbajtjen e kësaj rregullore do të flasim në kapitullin që ka të bëjë me kriteret dhe procedurat e faljes në Republikën e Kosovës.

## 2. ZBATUESHMËRIA E FALJES PRESIDENCIALE

<sup>24</sup> Neni 5; *Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar*, Nr. DF-001-2012; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 13 Janar, 2012.

<sup>25</sup> Neni 5.1; *Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar*, Nr. DF-001-2012; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 13 Janar, 2012.

<sup>26</sup> Neni 6; *Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar*, Nr. DF-001-2012; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 13 Janar, 2012.

<sup>27</sup> Neni 7.5; *Ibid.*

<sup>28</sup> *Rregullore (P) Nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar*; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 15 Nëntor, 2017.

## 2.1. Kriteret dhe procedurat e faljes presidenciale - Shqyrtime krahasuese

Kosova, sikurse secili shtet i cili e njeh institutin e faljes së personave të dënuar, ka legjislacion e gjithashtu edhe akte nënligjore të cilat e rregullojnë çështjen e kriterëve dhe procedurave që duhet ndjekur një person i dënuar në mënyrë që të kërkojë nga Presidenti në këtë rast falje. Ndër vite presidentët e Republikës së Kosovës, kanë nxjerrë akte nënligjore të cilat e kanë rregulluar çështjen e faljes.<sup>29</sup>

Përveç presidentëve të Republikës së Kosovës, faljen e kanë shfrytëzuar edhe ushtruesit e detyrës së Presidentit, pasi që nuk ka ndonjë kufizim real që do të mund të ndalonte ushtruesin e detyrës së Presidentit të mos e përdor këtë të drejtë, ani pse kjo kompetencë nuk ka të bëjë me zhbllokimin e shtetit nga ndonjë krizë në të cilën mund të vihet shteti.<sup>30</sup>

Në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese që janë vlerësuar amendamentet kushtetuese të propozuara nga Kryetari i Kuvendit<sup>31</sup>, gjithashtu është përmendur edhe falja si atribut, se a duhet të ushtrohet nga ushtruesi i detyrës së Presidentit apo jo<sup>32</sup>, ku nga parashtruesi i kërkesës

<sup>29</sup> Shih aktet nënligjore si në vijim të cilat kanë shërbyer për t'i plotësuar zbrazëtitrat që presidentët i kanë hasur gjatë procedurës së faljes së personave të dënuar: *Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar*, Nr. DF-001-2012; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 13 janar 2012; *Dekret për përcaktimin e kriterëve për dhënien e faljes personave të dënuar*, Dekreti numër DF 001-2009, Presidenti i Republikës së Kosovës, 30 janar 2009; dhe *Rregullore (P) Nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar*; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 15 nëntor 2017.

<sup>30</sup> Dispozita 160; Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese; *Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12; Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012*; Neni i ri 90.5 në veçanti thekson që disa kompetenca të rëndësishme, siç; janë përcaktuar në nenin 84, duhet të rrinë pezull derisa Presidenti nuk është në detyrë. Disa prej këtyre kufizimeve kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme të madhe për sigurinë e shtetit në kohë të jashtëzakonshme. Të tjerat kanë të bëjnë me udhëheqjen e duhur dhe të rregullt të shtetit kur ekziston nevoja për emërimin e gjyqtarëve apo të prokurorëve.

<sup>31</sup> Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese; *Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12; Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012*.

<sup>32</sup> Dispozita 168 dhe 169; Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese; *Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12; Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj*; 168: Neni i ri i

është kërkuar që kjo e drejtë të mos i lejohet ushtruesit të detyrës. Por, pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës Kushtetuese sa i përket asaj se a duhet t'i lejohet ushtruesit të detyrës së Presidentit, ushtrimi i atributit të faljes, Gjykata Kushtetuese ka konsideruar që një rast i tillë ka mundësi të madhe të ndikojë në një të drejtë dhe liri themelore, pra në të drejtën e lirisë, siç përcaktohet, ndër të tjera në Nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>33</sup> dhe Nenin 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.<sup>34</sup> Rrjedhimisht Gjykata konkludoi që neni i ri i propozuar 90.5 (5), nga parashtruesi i kërkesës, pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kriteret dhe procedurat e faljes në Republikës së Kosovës, aktualisht janë të rregulluara me Ligjin për Faljen<sup>35</sup> dhe me Rregulloren për Kriteret dhe Procedurat për Faljen e Personave të Dënuar.<sup>36</sup> Sipas Ligjit për Faljen, vetëm personi i shpallur fajtor për vepër penale dhe i dënuar me vendim përfundimtar nga ndonjë gjykatë e Kosovës gëzon të drejtën për tu falur nga Presidenti, përveç në rastet e parapara si në vijim: Personat e dënuar jashtë Kosovës, që janë duke e vuajtur dënimin në Kosovë, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për falje. Personi i cili me qëllim i shmanget ekzekutimit të dënimit për veprën penale nuk ka të drejtë të kërkojë falje. Personi i dënuar, kërkesa e të cilit është refuzuar nga Presidenti nuk ka të drejtë të kërkojë falje për veprën e njëjtë penale, përveç nëse mund të dëshmohet se janë paraqitur rrethana të reja që nga refuzimi i kërkesës së mëparshme. Personi i dënuar në bazë të Kreut

---

propozuar 90.5 (5) gjithashtu ia ndalon Ushtruesit të Detyrës së Presidentit shpalljen e faljeve individuale. Kompetenca fillestare sipas nenit 84 (29) është për Presidentin i cili "shpall falje individuale, në pajtim me ligjin". Tani propozohet që kur një person meriton të falet, në pajtim me ligjin, falja e tillë mund të mos lejohet; 169: Për shembull, falja e tillë mund të mos lejohet në një rast ekstrem të një personi që është duke vuajtur dënimin dhe i cili mund të meritojë të lirohet në pajtim me kompetencën për të shpallur falje individuale, pasi këtij personi do t'i kufizohet liria e tij/saj derisa Presidenti i ri ta fillojë mandatin. Në një rast të tillë, nuk mund të ketë mjete të tjera juridike në dispozicion për ta siguruar lirinë e tij/saj.

<sup>33</sup> Neni 29; *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, K-09042008*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë, 2008.

<sup>34</sup> Neni 5; *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (European Convention on Human Rights)*; Sekretariati i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; Nëntor, 1998.

<sup>35</sup> *Ligji për Faljen, Ligji Nr. 03/L-10*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë: Viti IV, Nr. 46; 15 Janar, 2009.

<sup>36</sup> *Rregullore (P) Nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar*; Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës; Prishtinë, 15 Nëntor, 2017.

XIII apo Kreut XIV të Kodit Penal të Kosovës, për veprën penale kundër Kosovës apo qytetarëve të saj apo kundër të drejtës ndërkombëtare nuk ka të drejtë të kërkojë falje.<sup>37</sup>

Në Republikën e Shqipërisë nuk ka ndonjë dallim të madh sa i përket faktit se kush ka të drejtë të kërkojë falje. Këtë e dëshmon Ligji për Faljen në Republikën e Shqipërisë, i cili thotë si në vijim: Kërkesa për faljen e dënimit bëhet personalisht nga personi i dënuar ose personi i pajisur me autorizim prej tij, sipas rregullave të legjislacionit në fuqi. Në rastin e personave të dënuar të mitur kërkesa për falje bëhet nga njëri prej prindërve, nga personi i autorizuar me prokurë prej tyre ose nga kujdestari.<sup>38</sup>

## 2.2. Historik i zbatimit të së drejtës kushtetuese të faljes në Republikën e Kosovës - Shqyrtim krahasues

Falja për herë të parë në Republikën e Kosovës është zbatuar me 17 shkurt 2009, nga Presidenti i atëhershëm Fatmir Sejdiu.<sup>39</sup>

Në vitin 2010, Presidenti Fatmir Sejdiu kishte falur të dënuar për Trafikim me Njerëz, që përbën shkelje flagrante të Kushtetutës dhe Ligjit për Faljen, pasi që falja e kësaj vepre është e ndaluar me ligj. Përveç këtij rasti, Presidenti Fatmir Sejdiu kishte falur edhe të dënuar për vepra penale të krimit të organizuar që ndërlidhen me narkotikët, raste të dhunimit, si dhe të dënuar të cilit nuk ishin rekomanduar fare nga Komisioni i tij për vlerësim. Në anën tjetër, ushtruesi i detyrës së Presidentit Jakup Krasniqi, që u gjend në këtë pozitë me gjithë këto fuqi në një periudhë gjashtë mujore tranzicioni, fali si në numër ashtu edhe në kohë shumë më shumë se që bënte Presidenti Sejdiu çdo vit. Në listën e të falurve të ushtruesit të detyrës së Presidentit hyjnë të dënuar recidivist, vrasje të rënda, si dhe të dënuar të cilët kanë pasur sjellje të këqija në burg, dhe vepra të korrupsionit. Të gjitha këto falje kanë ngritur dilema për vlerësime të padrejta dhe jomeritore nga ana e presidentëve.<sup>40</sup>

<sup>37</sup> Neni 4; *Ligji për Faljen, Ligji Nr. 03/L-10*; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë: Viti IV, Nr. 46, 15 Janar, 2009.

<sup>38</sup> Neni 8; *Ligji për Faljen i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10/295*; Qendra e Botimeve Zyrtare; Tiranë, 01 Korrik, 2010.

<sup>39</sup> <https://president-ksgov.net/sq/lajme/presidenti-sejdiu-dekretoi-faljen-e-62-te-denuarve>; Qasur për herë të fundit më 20.12.2020.

<sup>40</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi; “*Falja në Kosovë – Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirit me kusht*”; Prishtinë, Janar 2012; faqe 14

Shkeljet e vazhdueshme kanë ngritur shqetësime të ndryshme, ku falja tani shihet më shumë si njëmundësi keqpërdorimi sesa një mjet për të promovuar sjellje të mira të të dënuarve dhe dorën e butë të shtetit. Falja e të dënuarve e përcjellë me shumë anomali nuk ka kaluar pa u vërejtur nga Komisioni Evropian, ku Raportet e Progresit për Kosovën për 2010 dhe 2011 kanë ngritur këtë shqetësim.<sup>41</sup> Gjithashtu ky shqetësim sa i përket keqpërdorimit të faljes, si atribut që i takon Presidentit të Republikës së Kosovës, është ngritur edhe në Raportin e Progresit të vitit 2018, ku duke folur për trajtimin vendor të krimeve të luftës, vlerësohet se ka një mungesë vullneti për të hetuar, ndjekur e më pas gjykuar krimet e luftës për ish-pjestarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rrethimisht duke mos i hetuar e gjykuar, ky trajtim i vazhdueshëm preferencial i kriminelëve të dënuar të luftës në burgjet e Kosovës, sipas Raportit të Progresit të vitit 2018, rrezikon të ndikojë tek vullneti i dëshmitarëve për të bashkëpunuar në hetime. Një vëmendje e veçantë, në gjetjet e këtij raporti i kushtohet edhe faljes së tre pjestarëve të UÇK-së, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, ku vlerësohet se ky fakt ka ngritur brenga serioze.<sup>42</sup> Liritë e shumta dhe fuqia tepër e madhe e Presidentit në zbatimin e faljes kufizohet në faljen e të dënuarve të cilët kategorizohen si të pafalshëm në bazë të kapitujve XIII dhe XIV të Kodit Penal të Kosovës, ku bën pjesë edhe Trafikimi me Njerëz. Faljet e 16 shkurtit 2010 nga Presidenti Fatmir Sejdiu arritën kulmin e shkeljeve, pasi që Komisioni Ad hoc për Falje i kishte sugjeruar atij të fal të dënuarën për trafikim me njerëz. Kjo e fundit paraprakisht ishte refuzuar për t'u liruar me kusht nga Paneli për Lirim me Kusht për shkak të natyrës së veprës. Rrethanë për refuzim ishte serioziteti i veprës penale duke konsideruar si tepër të dëmshme për komunitetin, vendet e rajonit, dhe komunitetin ndërkombëtar në tërësi. Për më tepër përshkrimi i mëposhtëm zë vend në arsyetimin të gjykatësve të Panelit për Lirim me Kusht: "... Ajo me qëllim të përfitimit të saj personal detyrimisht e ka përfshirë të miturën që të ketë marrëdhënie seksuale me klient të ndryshëm.

Mëshira e Presidentit Fatmir Sejdiu për t'i falur gjashtë muaj të dënuarës për trafikim me njerëz ishte në kundërshtim me Ligjin për

<sup>41</sup> *Raporti i Progresit 2010 për Kosovën*; Bruksel: Komisioni Evropian; 9 Nëntor, 2010; faqe 11 - *Po ashtu, Raporti i Progresit 2011 për Kosovën*; Bruksel: Komisioni Evropian, 12 Dhjetor 2011; faqe 13

<sup>42</sup> *Raporti i Progresit 2018 për Kosovën*; Strasburg; 17.04.2018; faqe 18

Faljen.<sup>43</sup> Në vitin 2011, për herë të parë u.d. i Presidentit kishte ushtruar të drejtën për falje. Dekreti i faljes kishte përfshirë 135 vjet të falura për 103 të dënuar, kryesisht për vrasje dhe vrasje të rënda. Një gjë e tillë është evidentuar si shqetësim në raportet ndërkombëtare dhe vendore. Gjatë diskutimeve për ndryshime kushtetuese, ishte arritur konsensus që në propozimet për ndryshime të përfshihej kufizimi i kompetencave të u.d. Presidentit për të bërë falje.<sup>44</sup> Ndërsa, duke bërë një krahasim të faljeve të u.d. të presidentit të Kosovës, Jakup Krasniqi dhe ish presidentit amerikan John Kennedy, vërejmë një dallim enorm të numrit të faljeve. John Kennedy për 4 vjet ka falur tërësisht 472 të burgosur, 100 ulje të dënimeve dhe 3 shlyerje të dënimeve nga gjithësej 1749 kërkesa të pranuar<sup>45</sup>, ndërsa Jakup Krasniqi për 1 ditë me 1 dekret ka falur 103 të dënuar.

Gjithashtu për këtë rast kishte edhe reagime të shumëta nga shoqëritë civile, ku gjithashtu u ngritën dyshime se ish-presidentët, Fatmir Sejdiu, Jakup Krasniqi dhe Komisionet ad-hoc që kanë punuar me ish-presidentët rreth faljeve të tyre, janë duke u hetuar nga prokuroria për shkelje të Ligjit për Falje dhe të Kushtetutës. Këto dyshime i hedhi poshtë në atë kohë kryeprokurori i Qarkut në Prishtinë, Aleksandër Lumezi ku tha që nuk është ngritur ndonjë procedurë për ish Presidentët dhe Komisionet e tyre. Konkludimet e shoqërive civile ishin se ish presidentët kanë vepruar jo në përputhje me kriteret e Ligjit për Falje. Pas këtyre diskutimeve gjithashtu ka reaguar edhe Ismet Salihu i cili ka punuar në këto çështje dhe me përgjegjësi e bindje të plotë hedh poshtë të gjitha akuzat lidhur me keqpërdorimet e mundëshme. Ish-Presidenti Sejdiu ka reaguar duke thënë se faljet i ka ndërmarrë duke u konsultuar me institucionet përgjegjëse, ndërsa Jakup Krasniqi ka thënë se i është përmbajtur të gjitha kriteret ligjore gjatë shqyrtimit të kërkesave të të burgosurve për falje.<sup>46</sup> Falja e zbatuar në Kosovë në periudhën qeverisëse 5 vjeçare (koha kur kanë qeverisur Fatmir Sejdiu, u.d. Jakup Krasniqi dhe Atifete Jahjaga, por jo Hashim Thaçi për shkak të pamundësisë për t'u qasur në dokumente publike), pothuajse sikurse në të

<sup>43</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi; “*Falja në Kosovë – Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirit me kusht*”; Prishtinë, Janar 2012; faqe 14.

<sup>44</sup> Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese; *Rastet KO. 29/12 dhe KO. 48/12*; Amendamenti 8.

<sup>45</sup> [https://www.justice.gov/pardon/clemency-statistics?fbclid=IwAR2JrXarw6bpFjxqSW3xFofOIXSdn1XO8G0C18\\_5XfPCEkU28ZYIU0Qeg](https://www.justice.gov/pardon/clemency-statistics?fbclid=IwAR2JrXarw6bpFjxqSW3xFofOIXSdn1XO8G0C18_5XfPCEkU28ZYIU0Qeg);

Qasur për herë të fundit më 12.05.2022.

<sup>46</sup> Kronikë nga Top Channel; “*Falja Presidenciale në Kosovë*”; <https://www.youtube.com/watch?v=DhdDIgKyrM>; Qasur për herë të fundit më: 13.05.2022

gjitha vendet e tjera, ka ngritur polemika rreth rasteve të falura. Tre Presidentët (Sejdiu, Krasniqi dhe Jahjaga) i kanë falur pjesërisht dhe në tërësi rreth 250 vjet burgim për 246 të dënuar (11 nga to gra).

### **Conclusion**

The Power of Pardon is an authority of law, through which the President seeks to reward convicts for criminal offenses who have performed their debt to society for the offenses committed. To conclude with what was elaborated above, the pardon represents a decision of the President through which certain people are partially or completely released from the execution of the final sentence of the court. The concept of pardon also includes the replacement of the convict's sentence with a milder one. Further, the institute of pardon is seen as a means to show mercy to the convicts, especially this very important mechanism has been shown at the time and states where the death penalty has been applied to a large extent.

In Kosovo, after the Constitution of the Republic of Kosovo became effective and the Law on Pardon in 2009 was ratified, the President was granted the discretionary right to apply the instrument of pardon. The criteria that must be met by the convict to be eligible to seek pardon are: specific humanitarian reasons, compliance with the relevant rules for re-socialization and reintegration during the execution of the sentence, as well as the time spent in serving the sentence. There is also the pardon exemption, which prohibits a category of prisoners from seeking pardon from the President. In this case, the convicts can not be pardoned for any sentence for which the Parole Board has refused parole, are convicted of criminal offenses against the constitutional order and security of the Republic of Kosovo or criminal offenses against humanity and the values of protected by the international law of the Code. Convicts who are prohibited by pardon by a special law are also excluded from initiating a request to seek pardon.

The exercise of the authority of pardon in the past has greatly disturbed the convicts who had raised dilemmas about objective assessments. Furthermore, other groups and stakeholders have raised their concerns about the proper exercise of this authority granted to the President. Among them an important stakeholder involved was the European Commission. This was due to the fact that among the people who have been pardoned were people convicted of serious criminal

offenses including cruel murder, aggravated murder, organized crime, offenses related to narcotics, rape, and embezzlement while in office. Pardoned convicts with such criminal offenses has raised dilemmas over the standards and criteria set to seek pardon.

In particular, there have been uncertainties and doubts as to whether they enable objective assessment and that the criteria established by law has been fully respected by the Commissions which were set up in an Ad Hoc manner by previous Presidents. However, criticisms and doubts have been raised continuously about the proper usage of Pardon Power in Kosovo. It is worth noting that no president has been convicted in connection with the ‘wrong’ usage of the authority of pardon, although suspicions and violations have been identified. Another point that should be reviewed and modified in the legislation of the Republic of Kosovo is the amendment of the exercise of pardon power in certain periods. This coming to light might avoid eventual misuse of this authority in pre-elections time.

**Recensentë:**

**Prof. Dr. Arsim Bajrami**

**Prof. Dr. Florent Muqaj**

**Literatura**

- Salihu Ismet Dr; “E drejta penale – Pjesa e përgjithshme”; Prishtinë, Tetor 2015; faqe 569.
- Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë; Rasti Nr. PL. US 8/97, 24.06.1998
- Instituti i Kosovës për Drejtësi; “Falja në Kosovë – Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirimit me kusht”; Prishtinë, Janar 2012; faqe 6.
- Sebba Leslie; “The Pardoning Power - A World Survey”, Vol. 68, No. 1; Northwestern University School of Law; Printed in U.S.A. 1977.
- Muqaj Florent, Jashari Murat; “Presidenti si përfaqësues i unitetit të popullit”; Prishtinë, 2019; faqe 105.
- Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë
- Kodi i Përkohshëm Penal, UNMIK/RREG/2003/25
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, K-09042008;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji për faljen i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-10



- Ligji për Presidentin e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-094
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 06/L-074
- Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, Nr. DF-001-2012;
- Dekret për përcaktimin e kriterëve për dhënien e faljes personave të dënuar, Dekreti numër DF 001-2009
- Dekret për faljen e personave të dënuar, Nr. DF-001-2014
- Dekreti numër DF 001-2009, Presidenti i Republikës së Kosovës, 30 Janar, 2009;
- Rregullore (P) Nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar;
- Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese; Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (European Convention on Human Rights);
- Ligji për Faljen i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10/295
- Raporti i Progresit 2010 për Kosovën;
- Raporti i Progresit 2018 për Kosovën;
- Difference Between Amnesty and Pardon;  
[http://www.differencebetween.net/miscellaneous/culturemiscellaneous/difference-between-amnesty-andpardon/?fbclid=IwAR11rLTC\\_vG7uiIfA6vG2DJfVIgeTHPt\\_upS4Goc6jlkWT7zGkn785Vao0](http://www.differencebetween.net/miscellaneous/culturemiscellaneous/difference-between-amnesty-andpardon/?fbclid=IwAR11rLTC_vG7uiIfA6vG2DJfVIgeTHPt_upS4Goc6jlkWT7zGkn785Vao0);
- [https://www.justice.gov/pardon/clemency-statistics?fbclid=IwAR2JrXarw6bpFjxqSW3xFofOIXSdn1XO8G0C18\\_5XfPCEkU28ZYIU0Qeg](https://www.justice.gov/pardon/clemency-statistics?fbclid=IwAR2JrXarw6bpFjxqSW3xFofOIXSdn1XO8G0C18_5XfPCEkU28ZYIU0Qeg);